



---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

*Data: 07.08.2024*

Drejtuar: **P.F “Besnik Meci”, NIPT L12407012R**

*Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar.*

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara. **“Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për nevoja të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” për një periudhë 24 (njëzet e katër) muaj.**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-11029-06-25-2024**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“AEE SERVICE” sh.p.k.** me NUIS **L81530012C** dhe ofertë ekonomike me vlerë **7,159,000 (shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH;**
2. Operatori ekonomik **“ALSTEZO” sh.p.k.** me NUIS **J63208420N** dhe ofertë ekonomike me vlerë **7,340,000 (shtatë milionë e treqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH;**

3. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k., me NUIS L62311016C dhe ofertë ekonomike me vlerë 8,422,000 (tetë milionë e katërqind e njëzet e dy mijë) lekë pa TVSH;
4. Operatori ekonomik “Besnik Meçi” p.f., me NUIS L12407012R dhe ofertë ekonomike me vlerë 5,926,800 (pesë milionë e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH;
5. Operatori ekonomik “SERVIS – AUTO 2000” sh.p.k., me NUIS K31523078F dhe ofertë ekonomike me vlerë 6,254,520 (gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH;
6. Operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” sh.p.k., me NUIS L01314031G dhe ofertë ekonomike me vlerë 5,224,100 (pesë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm me arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “AEE SERVICE” sh.p.k. me NUIS L81530012C, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, konkretisht, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, lidhur me personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, pasi referuar formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, **rezulton se nuk disponon 1 (një) punonjës xhenerik dhe 1 (një) punonjës elektroauto.**
2. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k., me NUIS L62311016C, për shkak se me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, konkretisht, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër, konkretisht 4,692,727 lekë pa TVSH. **Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik ka paraqitur fatura tatimore shitje të ndryshme, vlera totale e të cilave është 3,332,856 lekë pa TVSH, duke mos plotësuar vlerën e kërkuar për përvojën e mëparshme.**
3. Operatori ekonomik “SERVIS – AUTO” sh.p.k., me NUIS K31523078F, për shkak se me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, konkretisht, Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT pasi **operatori ekonomik nuk posedon Leje mjedisore të tipit B.**

4. Operatori Ekonomik “VILNIK MOTORS” sh. p. k., me NUIS L01314031G, pasi në zbatim të pikës 3, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

$Zm = 85 \% \times Mo = 85\% \times 6,163,633.33 = 5,239,088.33$  lekë pa TVSH.

Nga përlllogaritja rezultoi se oferta e paraqitur nga OE “VILNIK MOTORS” sh.p.k., me NUIS L01314031G është anomalisht e ulët.

Për rrjedhojë dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, **autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “**Besnik Meçi**” p.f., me NUIS **L12407012R**,

oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5,926,800 (pesë milionë e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH,

se është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Arlinda POGAJ**